



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prudato Received/Delivery	28 - 12 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	8550/2022		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1003/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikj Demi-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër Anr.1003/2022 të datës 14.11.2022 e parashtruar përmes formes elektronike në adresën zyrtare [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), nga ankuesi me adresë: në Komunë të Deçanit, kundër organit të punësimit Komunës së Deçanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.1003/2022 të datës 14.11.2022 të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 14.11.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 7057/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor kundër vendimit me numër Nr.02 të datës 10.11.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Deçanit,

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokollit 7054/2022 të datës 14.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes formës elektronike në adresën zyrtare [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net); Konkursi i shpallur me datë 24.08.2022 ka aplikuar në emërimin e grupit Specialist Ligjor, për pranimin në pozitë: Zyrtar për leje ndërtimore; Certifikat Nr.2016/0103; Certifikat e datës 04.01.2022, e datës 19.02.2020, e datës 14.09.2022, e datës

13.09.2022, e datës 16.09.2022, e datës 11.09.2015, e datës 27.10.2004, e datës 11.10.2022, e datës 07.10.2020; Diplomë nga studimet themelore të Universitetit "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik i datës 03.11.2015 nr.229, e ankuesit; Diplomë Master nga Universitetit "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik i datës 02.03.2021 nr. 100, i ankuesit; Vërtetim i punës i datës 30.11.2021 lëshuar nga kompania Pejë; Letër reference e datës 27.09.2022 lëshuar nga Fondi i sigurimit shëndetësor; Vërtetim i datës 13.12.2017 lëshuar nga Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 08.11.2022 nga procedura e rekrutimit; Vendimi Nr.02 i datës 10.11.2022 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Decanit; Akt percjelles për përgjigje në ankese e datës 22.11.202 nga Komuna e Decanit; Aplikacioni i datës 26.09.2022 i ankuesit; Vërtetim i datës 09.07.2019 i kompanisë në Pejë; Certifikat Nr.2016/0330; Aplikacioni i datës 16.09.2022, Diplomë nga studimet themelore të Universitetit "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik i datës 19.09.2015 nr.193, e ankuesit; Certifikat e datës 16.12.2015; Certifikat e datës 06.01.2017 lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë; Certifikat e datës 01.10.2019; Vërtetim i datës 13.09.2022; Vërtetim i datës 01.09.2022, Vërtetim i datës 05.09.2022; Reference pa datë; Referencë e datës 05.12.2016; Njoftim i përshirjes në listen e ngushtë të datës 30.09.2022; Njoftimi i datës 09.11.2022, Vendimi i komisionit të pranimit i datës 06.10.2022; Ankesë e datës 09.11.2022 parashtruar tek komisioni i pranimit; Kërkesë për tërheqje të ankesës nga ankuesi për mes emailit të datës 16.12.2022 [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ e filluar me ankesën me numër A.nr.1003/2022 të datës 14.11.2022 e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës Kolegji, gjenë së ankuesi me datë 14.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7057/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 16.12.2022 ankuesi ka parashtruar kërkesë për mes Emailit: [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net), për tërheqje të ankesës me numër të protokollit 7057/2022 të datës 14.11.2022 me arsyetim se: *"kërkoj nga ana e juaj që ankesa ime e dorëzuar tek ju me datën 14.11.2022, të mos trajtohet tutje nga organi i juaj dhe si i tillë të trajtohet si e tërhequr në mënyrë të vullnetshme nga ana ime"*.

Në bazë të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 103 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, andaj duke u nisur nga veprimi administrativ i ankueses për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshill, Kolegji konstaton që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.1003/2022 e datës 14.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1003/2022

Zyle Millaku Gojnovci

  
Pracësbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesi
- Kryetarit të Komunës së Decanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Decanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

